



## URDHËR

Nr. 39866, datë 03/11 2017

### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT PËR PROJEKTIN “FUQIZIMI I GRAVE DHE NXITJA E SIPËRMARRJES (II)”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “d” dhe nenit 64, shkronja “b” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vendimit nr. 96 datë 28.09.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin dhe zbatimin e Projektit “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes II” hartuar sipas Udhëzuesit Operacional për zbatimin e projektit “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes (II), në bashkëpunim me United Nations Development Programme (UNDP), me qëllim transparencën e plotë gjatë procesit të shqyrtimit, vlerësimit të dokumentacionit dhe përzgjedhjes së aplikantëve, sipas kritereve të përcaktuara në këtë projekt,

#### URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit për projektin “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes (II)”, me përbërjen si më poshtë:
  - Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale (Anëtar)
  - Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar (Anëtar)
  - Përfaqësues nga UNDP (Anëtar)
2. Komisioni, i ngritur sipas pikës 1 të këtij urdhri të kryesohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale dhe të kryejë të gjitha detyrat e parashikuara në udhëzuesin operacional, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit nr. 96, datë 28.09.2017 të Këshillit Bashkiak.
3. Renditja përfundimtare e listës së përfituesve të grantit, sipas totalit të pikëve për planet e biznesit, të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë dhe/ose në stendat e informimit të saj.
4. Nëse asnjë aplikante nuk paraqet ankesë brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i njoftimit të saj dhe/ose pas shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Vlerësimit, dhe pas ezaurimit të fazës së regjistrimit të bizneseve të reja, të vijohet me lidhjen e kontratave me aplikantët përfitues për transferimin e grantit, sipas afateve dhe përqindjeve të parashikuara në udhëzuesin operacional.
5. Ngarkohen Komisioni i Vlerësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELLAJ

